



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVË

Numri i lëndës: 2021:183432

Datë: 27.12.2023

Numri i dokumentit: 05130977

C.nr. 6172/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Qëndresa Beqiri Murati, në çështjen juridike kontestimore të paditësve D. M dhe B. I, të dy nga Obiliqi, të cilët sipas autorizimit i përfaqësojnë B. U dhe L. H, të dy avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Obiliqit - Drejtoria Komunale për Arsim me seli në Obiliq, me objekt kontesti kompensimin e shujtave ditore në punë dhe shpenzimeve të udhëtimit, jashtë seancës, me datë 27.12.2023 mori këtë:

AKTGJYKIM

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve D. M dhe B. I, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Obiliqit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datë 28.02.2021, t'ua kompensoj shumat si në vijim:
  - paditësit D. M në emër të kompensimit për ushqim, për 517 ditë pune, t'ia paguaj shumën prej 1,034.00 euro, ndërsa në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në lartësi prej 70% të biletës së autobusit, shumën prej 289.52 euro, gjithsej shumën prej 2,358.52 euro;
  - paditësit B. I në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës, për 785 ditë pune, t'ia paguaj shumën prej 1,570.00 euro;
  - të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së kërkesëpadiës me datën 23.07.2021 e deri në pagesën e tërësishme;
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Obiliqit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 176.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit, nën kërcënim të përbarimit më ligjor.

## A r s y e t i m

Paditësit D. M dhe B. I, të dy nga Obiliqi, përmes të autorizuarve të tyre, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë me datë 23.07.2021 kanë parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Obiliqit - Drejtoria Komunale e Arsimit me seli në Obiliq, për kompensimin e shujtave ditore dhe shpenzimeve të transportit. Paditësit, në padi, ndër të tjera, kanë theksuar se janë në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura dhe atë në pozitën e mësimit në SH.F.M.U “M...”, dhe se paditësi D. M ka 517 ditë pune në këtë shkollë dhe për çdo ditë për vajtje dhe ardhje ka paguar biletën e autobusit në vlerë prej 0.80 euro, ndërsa paditësi B. I ka 785 ditë pune në këtë shkollë, ndaj të njëjtit edhe i kanë plotësuar kushtet për realizimin e kompensimit të shujtave ditore dhe shpenzimet e transporti ashtu siç parashihet me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, e hyrë në fuqi me datë 18.04.2017. Tutje kanë theksuar se e paditura nuk e ka paguar shujtën për ushqim ditor dhe as shpenzimet e transportit ashtu siç përcaktohet në kontratën në fjalë.

Përmes parashtrës së dorëzuar në gjykatë me datë 05.10.2022, kërkesën e padisë e ka precizuar ashtu që nga gjykata kanë kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit D. M në emër të shujtës ditore për ushqim për periudhën nga data 18.04.2017 e deri më 28.02.2021, për 517 ditët e pranisë në punë, t’ia kompensojë shumën prej 1,034.00 euro, dhe në emër të shpenzimeve të transportit për përrudhën e njëjtë në lartësi prej 70% të biletës së autobusit ka kërkuar t’ia kompensojë shumë prej 289.52 euro, ndërsa për paditësin B. I në emër të shujtës ditore për ushqim për periudhën prej 18.04.2017 deri më 28.02.2021, për 785 ditët e pranisë në punë, ka kërkuar t’ia kompensojë shumën prej 1,570.00 euro, e të gjitha këto shuma me kamatë 8% nga dita e parashtrimit të padisë e deri te pagesa përfundimtare. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar për përpilim të padisë në shumën prej 156.00 euro, si dhe shpenzimet tjera që krijohen gjatë procedurës.

E paditura në përgjigjen në padi ka theksuar se paditësve ju takon e drejta për kompensimin e shujtave ditore sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 17.04.2017, mirëpo e paditura nuk ka obligim ndaj paditësve pasi që e njëjta nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, ku në nenin 37 të së cilës është përcaktuar se *“Palët nënshkruese të kësaj kontrate kolektive janë të obliguara që të zbatojnë dhe ti respektojnë dispozitat e kësaj kontrate”*, e që rrjedhimisht e paditura nuk është përgjegjëse për të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga kjo kontratë. Tutje ka theksuar se e paditura nuk ka obligim e as të drejtë të bëjë ndarje buxhetore për këto lloje të kompensimit, për shkak se me nenin 46 të Kontratës Kolektive të Arsimit të vitit 2017, obligim për sigurimin e mjeteve që kanë implikime financiare nga kjo kontratë e ka MASHT-it, SBASHK-ut, Ministrisë të Financave e jo komuna e Obiliqit. Po ashtu edhe me neni 90, paragrafi 5 i Ligjit të Punës, ka përcaktuar se *“Marrëveshja kolektive vlen vetëm për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*, dhe se e paditura nuk ka marrë përsipër detyrimet e kësaj kontrate kjo duke e marrë parasysht edhe rrethanat e vitit 2021/2022 ku e paditura është ballafaquar me pandeminë globale Covid-19 dhe se primare për të ka qenë siguri i pagave dhe mëditjeve të mësimit në SH.F.M.U dhe jo kërkesat e tilla, ndërsa në të ardhmen primare do të jenë pagat jubilarë dhe shujtat e mësimit në SH.F.M.U. Andaj,

bazuar në të dhënat si më lart, i ka propozuar gjykatës, që padinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e provave të bashkangjitura padisë, si dhe pas pranimit të përgjigjes në padi, dhe parashtresës së datës 05.10.2022, mbi precizimin e padisë, e të cilën palës së paditur gjykata ia ka dorëzuar me datë 25.10.2023, mbështetur në nenin 8 dhe 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, porse e paditura ka ngritur çështje që kanë të bëjnë me pamundësinë e përmbushjes së detyrimit dhe mungesës së përgjegjësisë së të njëjtës për përmbushjen e këtij detyrimi, si dhe faktin se e njëjta nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit. Në këtë rast kontestues është vlerësuar se nuk ka pengesa në kuptim të dhënies së vendimit meritor jashtë seance.

Nga provat e bashkangjitura padisë gjykata gjeti se paditësi D. M është në marrëdhënie pune tek e paditura, sipas kontratës së punës me numër 03-XI/2020, të datës 03.11.2020. Gjykata përmes vërtetimit për ditët e prezencës në punë me numër të protokollit 1316/4, i datës 10.06.2021, gjeti se paditësi për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datë 28.02.2021 ka qenë gjithsej 517 ditë prezentë në punë, ndërsa nga certifikata e vendbanimit me numër serik B 10328507, e datës 10.06.2021, vërtetohet se paditësi D. M ka adresë të vendbanimit në komuna Obiliq, ndërsa nga vërtetimi dhe kuponat fiskal të lëshuar nga Operatori transportues “D...”, vërtetohet se paditësi për periudhën e njëjtë ka udhëtuar me operatorin në fjalë dhe ka paguar 0.40 euro për një drejtim.

Gjykata në bazë të kontratës të punës të datës 01.09.2017, gjeti se paditësi B. I është në marrëdhënie pune tek e paditura, dhe atë në Sh.M.F.U “ M...”, ndërsa me vërtetimin me numër protokollit X-361 i datës 10.06.2021 u vërtetua se paditësi për periudhën kohore nga 18.04.2017 deri me datë 28.02.2021 ka qenë gjithsej 785 ditë prezentë në punë.

Nga provat e cekura si më lartë, gjykata gjeti se paditësit nuk kanë pranuar kompensimin në emër të ushqimit dhe as kompensim të shpenzimeve të udhëtimit për ditët e kaluara në punë, në kohën sa ka qenë në fuqi KKAK. Nga vërtetimi i datës 10.06.2021, me numër protokollit 1316/04, lidhur me këtë pjesë të kërkesëpadisë, gjykata gjen se paditësi D. M ka qenë prezentë në punë 517 ditë, për përuhdën si në precizim të kërkesëpadisë, nga data 18.04.2017 e deri më 28.02.2021, ndërsa nga vërtetimi i datës 10.06.2021, me numër protokollit X-361, gjykata gjeti se paditësi B. I ka qenë prezentë në punë 785 ditë, prandaj gjykata ditët e kaluara në punë të paditëseve i ka shumëzuar me nga 2 euro, rrjedhimisht duke i njohur paditësve shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë lloj kompensimi gjykata ia njohu paditëseve në harmoni me nenin 35 paragrafi 7, të KKAK-së i cili ka përcaktuar se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqime gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2(dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore”*.

Sa i përket pjesës së kërkesëpadisë së paditësit D. M për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, gjykata në bazë të certifikatës së vendbanimit..., e datës 10.06.2021, gjeti se paditësi D. M ka adresë të banimit në, ndërsa nga vërtetimit dhe kuponat fiskal të lëshuar nga Operatori transportues “D...”, gjeti se paditësi për periudhën e si në precizim të kërkesëpadisë për 517 ditë pune ka udhëtuar me këtë kompani në linjën Prishtinë - Obiliq – dhe anasjelltas, dhe ka paguar 0.40 euro për një drejtim, duke llogaritur 70% nga çmimi i biletës (vajtje - ardhje 0.80 euro) x 70% = 0.56 euro x 517 ditë pune = 289.52 euro, krejt kjo në harmoni me nenin 35 par.5, të KKAK-së i cili ka përcaktuar se *“Punonjësit arsimorë që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*.

Nga të lartcekurat gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit aprovues jashtë seance, në kuptim të nenit 398 i LPK-së, sipas të cilit *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Duke qenë se ka lindur e drejta e paditëseve për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për ushqim gjatë punës dhe shpenzime të udhëtimit, të njëjti janë legjitimuar që të kërkojnë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditësit e kanë rolin e kreditorit, kurse e paditura rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili ka përcaktuar se *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditësve, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, gjykata vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësve t’ia kompensoj shumën si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata, pretendimet e të paditurës të ngritura përmes përgjigjes në padi se nuk kanë linjë buxhetore të ndarë për pagesën e shujtave dhe shpenzimeve të transporti i gjen si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme. Paditësit në rrugë gjyqësore kanë filluar të realizojnë një të drejtë ligjore që i garanton KKAK, kurse mungesa e linjës së veçantë buxhetore të të paditurës, si dhe pretendimi se e njëjta nuk është përgjegjëse për faktin se nuk është palë nënshkruese e kësaj kontrate, nuk mund të ketë për efekt vendosjen ndryshe.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*. Ndërsa paragrafi 2 i këtij neni ka përcaktuar se *“Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*, e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë datë 23.07.2021.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 452 paragrafi 1 të LPK – së, i cili ka përcaktuar se *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”*. Lartësia e shpenzimeve të

procedurës të aprovuara në shumë prej 176.00 euro i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumën prej 156.00 euro dhe shumën prej 20 euro për taksë gjyqësore në padi.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË  
Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.6172/2021, datë 27.12.2023

Gjyqtarja  
Qëndresa Beqiri Murati

**KËSHILLË JURIDIKE:** *Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.*